

## A mund të marr mbështetje edhe për nevoja të tjera?

Ekzistojnë edhe shumë nevoja të tjera, të drejta dhe mundësi mbështetjeje, që rrjedhin prej tyre. Në këtë renditje përmenden vetëm shembuj.



Tregoni mbi nevojat tuaja në një qendër këshillimi dhe informohuni aty mbi mundësitë tuaja.

Aty ju do të merrni ndihmën, për të gjetur mbështetjen e duhur për zbatimin e të drejtës së pjesëmarrjes.



## E drejta ime për pjesëmarrje

e shpjeguar thjesht.



[www.einfachmeinrecht.awo.org](http://www.einfachmeinrecht.awo.org)

[www.einfachmeinrecht.awo.org](http://www.einfachmeinrecht.awo.org)



## Çfarë nënkupton për mua e drejta për pjesëmarrje?

Të gjithë njerëzit, që kanë të drejtë qëndrimi të rregullt në Gjermani, kanë të drejtë të marrin pjesë në jetën aty. Këtu hyjnë, mundësia për t'u zhvilluar në mënyrë individuale, mundësia për arsimim dhe kulturë si dhe përfitimi për një mbështetje bazë.


## A kam të drejtë për mbështetje?

Sigurisht që të gjithë njerëzit kanë nevoja të ndryshme. Për shumë njerëz ekziston e drejta për mbështetje. Në rast se ju nuk e siguron dot vetë jetesën tuaj, ju keni të drejtë të merrni ndihmë sociale.

Gjatë shtatzanisë, ju keni të drejtën e përkrahjes përpara, gjatë dhe pas lindjes së fëmijës. Ju mund të merrni gjithashtu mbështetje financiare për fëmijën e porsalindur.




Në rast se ju jeni sëmure, ju garantonet shërbim shëndetësor. Këtu përfshihen e drejta e kontrollit dhe trajtimit të duhur mjekësor.



Nëse nuk ndjeheni mirë emocionalisht ose psikikisht ju, mund të kërkon mbështetje për të gjetur një rrugëdalje nga kjo situatë.

Nëse ju jeni i moshuar dhe nuk jeni në gjendje të kujdeseni vet ë për veten, ju keni të drejtë të merrni ndihmë dhe kujdes infermieror.

Njerëzit me aftësi të kufizuara kanë të drejtën e mbështetjes materiale ose financiare dhe, sipas nevojës, edhe përkujdesje të vazhdueshme.



Fëmijët kanë të drejtë të përfitojnë një vend në qendrat e kujdesit ditor (kopsht) si edhe në shkollë. Nëse ata janë pa prindërit e tyre në Gjermani, kanë të drejtën që dikush të kujdeset për ta.

Familjet kanë mundësinë të kërkojnë ndihmë, nëse kanë probleme brenda familjes dhe janë duke kërkuar një zgjidhje.



Njerëzit me probleme varësie ose me borxhe mund të kërkojnë të marrin mbështetje. Njerëzit, që përjetojnë diskriminim ose dhunë mund të marrin mbështetje.